



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:034835
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06225791

C-IV-14-5778

Ankuesi

R L fshati G e U, Lipjan.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Lakrishtë, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, me 27 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e ankuesit kundër Vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, Nr. PRN051-0063, i dt.09.07.2014, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 08 gusht 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN051-0063, të datës 09.07.2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për tri pagat e pa paguara për periudhe të pa specifikuar, në shumë prej 540.00 Euro, nga NSH “Seperacioni i Gurëve Gadime”, (në likuidim). Ankuesi pohoi se vendimi i AL-së, se kërkesa është parashkuar nuk është i drejte se ai ka dorëzuar me kohe kërkesën për 20%-shin, si dhe pas kërkesës së AKP-së për plotësimin e dokumentacionit brenda afatit ka dorëzuar kërkesën për kompensimin e tre pagave te papaguara. Ankuesi tutje pohoi se AL-ja ka për obligim qe kërkesat për kompensimin e pagave ti trajtoje me prioritet e gjithë kjo sipas nenit 40.1.6.1 të Ligjit nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare te Privatizimit. Ankuesi i propozon Gjykatës që të aprovohet në tërësi ankesa e tij si e bazuar, dhe të anulohet vendimit i AL-së PRN051-0063, i dt. 09.07.2014, dhe ti njihet e drejta në kompensimin e tri pagave te papaguara në shumën prej 540.00 euro.

Në mbështetje të ankesës dorëzoi: vendimin e kundërshtuar, PRN051-0063, të datës 09.07.2014, si dhe vendimi i AL-se PRN051-0062, dhe të datës 09.07.2014, i cili vendim nuk është atakuar me ankese, dhe asnjë provë tjetër.

Me 19 gusht 2024, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin, përmes së cilit urdhër ju kërkua që të dorëzoi, kopjen e Librezës së Punës, listën e pagave të mbetura borxh të lëshuara nga NSH-ja, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe prova tjera shtese në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore. Ankuesi me datën 21.08.2024, pranoi urdhrin e lartcekur, por i njëjti nuk u përgjigj në urdhrin e gjykatës.

Me 28 gusht 2024, e paditura parashtroi përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Më tej e paditura pohoi ankuesi nuk ndërmori asnjë veprim ligjor për të kërkuar kompensim brenda periudhës së parashkrimit. Po ashtu e paditura theksoi se parashtruesi ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe neni 31 i Shtojcës së Ligjit 06/L-086). E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit kundër vendimit të AL Nr. PRN051-0063, refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh tri pagat e kërkuara në shume prej 540.00 euro. Ankuesi nuk ka ofruar argumente, si në procedurën e likuidimit pranë AL e as pranë gjykatës, me anë të kërkesës për rishqyrtim-ankesë, argumente të cilat do të dëshmonin të drejtën në tri paga të papaguara. Po ashtu ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas urdhrin të lëshuar nga gjykata të datës 19 gusht 2024.

Është me rëndësi të theksohet fakti se gjykata edhe në këtë çështje juridike vendos mbi bazën e fakteve dhe provave që kanë parashtruar palët, për të cilën pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi që do të vërtetonte se pala ankuese nuk ka realizuar pagat për një periudhë të caktuar kohore, andaj nuk mund të merret si e drejtë kërkesa e parashtruesit, nëse të njëjtën kërkesë nuk e ka bërë të besueshme përmes ndonjë fakti apo prove që gjykata të aprovonte kërkesën e tillë. Baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme. Pra, në këtë kuptim, ankuesi ka dështuar që të parashtrtojë prova në mbështetje të kërkesës së tij të përcaktuara me nenin 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tri paga të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është e liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit është nën 1000 €.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Manushe Karaçi, Gjyqtare